



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 1144, datë 24.12.2020

P Ë R

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN
E RINDËRTIMIT TË OBJEKTIT “*ATRIUM CENTER THUMANA*”,
NJËSIA ADMINISTRATIVE THUMANË, BASHKIA KRUIJË,
DHE CAKTIMIN E BASHKISË KRUIJË SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16, dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të objektit “*Atrium Center Thumana*”, njësia administrative Thumanë, Bashkia Krujë, në vlerën 220 210 898 (dyqind e njëzet milionë e dyqind e dhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.
2. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020, për financimin e rindërtimit të objektit “*Atrium Center Thumana*”, njësia administrative Thumanë, Bashkia Krujë, të jetë në vlerën 44 042 180 (dyzet e katër milionë e dyzet e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH dhe të përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit.
3. Caktimin e Bashkisë Krujë si njësi zbatuese për rindërtimin e objektit “*Atrium Center Thumana*”, njësia administrative Thumanë, Bashkia Krujë.

4. Fondi për financimin e rindërtimit të objektit arsimor “*Atrium Center Thumana*” i transferohet në formën e transfertës së pakushtëzuar njësisë zbatuese, Bashkisë Krujë.
5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRACE

**MINISTRI I SHITIT
PËR RINDËRTIMIN
ARBEN AHMETAJ**

NR.PROT. 38/1
DATË 12.1. 2021

MINISTRIT TË SHETIT PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
BASHKISË KRUJË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI



A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Engjell Agaci', is written over a circular blue official stamp. The stamp contains the text 'MINISTRI I TRANSPORTIT, ENERGJISË DHE ENERGJITIKË' and 'REPUBLIKA E SHqipërisë'.